



Massachusetts Department of Elementary and Secondary Education

75 Pleasant Street, Malden, Massachusetts 021486

Telefon: (781) 338-3000
TTY: N.E.T. Relay 1-800-439-2370

Jeffrey C. Riley
Komisioner

9 Prill 2020

Të dashur familjarë dhe kujdestarë,

Gjatë kësaj periudhe të mbylljes së zgjatur të shkollave, ne e kuptojmë se kjo është një kohë e vështirë për familjarët, kujdestarët dhe ndihmë dhënësit. Ne jemi të ndërgjegjshëm se një nga shqetësimet tuaja është se si fëmijët me aftësi të kufizuara do të vazhdojnë të marrin mbështetje dhe shërbime nga shkollat ndërsa ato janë të mbyllura për shkak të emergjencës së shëndetit publik në lidhje me Covid-19. Gjatë kësaj kohe të jashtëzakonshme, ne vlerësojmë që familjarët dhe mësuesit të punojnë se bashku për të ofruar aksesin më të mirë të mundshëm për arsimin dhe shërbimet e posaçme.

Me këtë letër dua të ndaj me ju disa informacione të rëndësishme rreth çfarë po bëjnë shkollat për të mbështetur fëmijën tuaj gjatë kësaj periudhe. Dokumenti shoqëruar i paketës së burimeve për familjarët ju jep informacion të dobishëm rreth burimeve dhe strategjive për këto familje.

Më 21 mars, Departamenti i Shteteve të Bashkuara për Arsimin (USED) ka nxjerrë një [fletushkë informative](#) ku sqaron se shkollat duhet të vazhdojnë të ofrojnë mësimdhënie pa pagesë dhe të përshtatshëm (FAPE) për studentët me aftësi të kufizuara ndërsa mbrojnë shëndetin dhe sigurinë e studentëve, mësuesve dhe ofruesve të shërbimeve. Në kushtet e jashtëzakonshme që jetojmë, shërbimet e arsimit special do të ofrohen në një formë të ndryshme nga sa ofrohen kur shkollat janë të hapura dhe funksionojnë plotësisht. Shërbimet e arsimit special në distancë duhet të fillojnë menjëherë. Nuk kërkohet pëlqimi juaj për të filluar shërbimet në distancë. Ju do të merrni një plan që do t'ju tregojë se si shkolla do t'i ofrojë këto shërbime në distancë.

Në Massachusetts, mësimi në distancë për të gjithë studentët, përfshi edhe studentët me aftësi të kufizuara, do të ofrohet duke përdorur:

1. **Mbështetje dhe burime** për një mësim të pavarur ku përfshihet lënda akademike dhe paketat e detyrave në shtëpi si dhe oportunitete për mësim bazuar tek projektet sipas nevojave të fëmijës suaj.
2. **Mësimdhënia dhe shërbimet** do të ofrohen në distancë në klasa me grupe të mëdha, të vogla ose individuale. Mësimdhënia dhe shërbimet mund të ofrohen duke përdorur programet në internet, televizionin ose telefon.

Më poshtë janë disa ide kyçe për tu pasur parasysh.

Komunikim i rregullt dhe i vazhdueshëm midis mësuesve dhe familjeve është i rëndësishëm. Mësuesi i fëmijës suaj dhe ofruesit e shërbimeve përkatëse do të jenë në kontakt të vazhdueshëm me ju. Ju dhe mësuesit e fëmijës suaj dhe ofruesit e shërbimeve përkatëse duhet të vendosni se sa shpesh dhe cila metodë e komunikimit funksionon më së miri për ju, diskutoni mbi udhëzimet e individualizuara për fëmijën tuaj, objektivat e IEP dhe nevojat e shërbimit dhe planifikoni se si shërbimet mund të ofrohen nga distanca. Informoni ekipin tuaj të shkollës se cilat çështje ju shqetësojnë më shumë për fëmijën tuaj dhe u thoni atyre mënyrën më të mirë për t'u lidhur me ju, qoftë me e-mail, telefon apo forma të tjera.

Fëmija juaj mund të mos marrë mësim dhe shërbime të individualizuara në të njëjtën mënyrë si kur shkolla është e hapur. Ju dhe mësuesit e fëmijës suaj dhe ekipi i shkollës mund të jeni krijues në hartimin e

mënyrave për të ofruar mundësi mësimi në distancë, udhëzime speciale për arsimin dhe shërbime. Mund të mos jetë e mundur të sigurohen terapi ose mësim praktikë, ballë për ballë, si pasojë e masave të sigurisë publike për të ruajtur distancimin social. Mundësitë e specializuara mësimore dhe shërbimet përkatëse mund të modifikohen ose sigurohen nga distanca në mënyrë që fëmija juaj të marrë FAPE. Shkolla duhet t'ju japë një plan të mësimi në distancë në mënyrë që të njiheni me planin dhe programin e marrjes së mësimi, shërbimeve dhe oportuniteteve të tjera nga fëmija juaj.

IEP i fëmijës tuaj rendit mbështetjet dhe akomodimet që e ndihmojnë të ketë sukses në shkollë dhe ju gjithashtu mund t'i përdorni ato gjatë aktiviteteve të përditshme në shtëpi. Shkolla do të sigurojë që fëmija juaj të ketë mundësi në distancë përmes akomodimeve të përshtatshme. Rishikoni IEP-në e fëmijës suaj me mësuesin e fëmijës tuaj për të zbatuar format më të përshtatshme për fëmijën tuaj dhe të kuptoni se si t'i përdorni ato në shtëpi. Në rast se nuk keni një kopje të IEP-së, kontaktoni mësuesin e fëmijës tuaj që t'ju dërgohet një kopje dhe caktoni një orë takimi për të diskutuar rreth IEP-s së fëmijës me mësuesin në telefon.

Ju mund të përdorni teknologjinë ndihmëse. Shembuj të tillë përfshijnë softuare, pajisje komunikimi, makina llogaritëse, aplikacione të kthimit të folurit në tekst dhe titra me dekoder dhe pajisje të tjera të specializuara për të ndihmuar fëmijën tuaj të marrë mësim në shtëpi. Mësuesi dhe drejtuesit e shkollës të fëmijës suaj do t'ju kontaktojnë për të punuar së bashku për të gjetur mënyrat më të mira për t'i inkuorporuar këto pajisje dhe teknologji në jetën tuaj të përditshme. Në rast se pajisja e specializuar që do të përdoret nga fëmija juaj ndodhet në mjediset e shkollës, mund të flisni me drejtuesit e shkollës se si mund të keni akses në të.

Takimet për IEP mund të zhvillohen virtualisht ndërkohë që shkollat janë të mbyllura. Takimet virtuale IEP janë një zgjidhje e mirë për të zbatuar rregullat e distancimit social. Mund të merrni pjesë në takimet virtuale IEP me telefon ose video konferencë.

- Në rast se ka ardhur koha për IEP, ju inkurajojmë të punoni me ekipin e fëmijës tuaj për të vendosur në rast se është e mundur të zhvillohet një takim virtual IEP.
- Kur të rifillojë shkolla, mësuesit e fëmijës suaj do të shqyrtojnë progresin e fëmijës dhe do të zhvillojnë një takim IEP me ju sipas nevojës për të përcaktuar hapat e ardhshme.

Kontaktoni mësuesin ose drejtuesit e shkollës në rast se hasni probleme teknike gjatë aksesimit të mësim dhënies dhe burimeve në distancë. Shfrytëzimi i burimeve në internet është një formë e re për shumë familje dhe ne pranojmë faktin se shumë prindër kanë nevojë për mbështetje teknike. Informojeni shkollën në rast se keni ndonjë pyetje ose keni nevojë për ndihmë.

Në rast se shkolla e miratuar private e fëmijës tuaj është e mbyllur, arsimtarë nga shkolla e miratuar e arsimit special do të kontaktojnë me ju për të përcaktuar se si shkolla do të vazhdojë të ofrojë shërbimet e mësimi në distancë. Shkolla e miratuar për mësim special duhet t'ju japë një plan të mësimi në distancë në mënyrë që të njiheni me planin dhe programin e marrjes së mësimi, shërbimeve dhe oportuniteteve të tjera nga fëmija juaj.

Në rast se fëmija juaj ka një plan 504, mësuesi i fëmijës suaj dhe/ose Koordinatori 504 do të kontaktojnë me ju për t'ju treguar se si mund të ofrohen akomodimet dhe shërbimet që janë parashtruar në planin 504 të fëmijës. Mësuesi i fëmijës suaj do t'ju shpjegojë se si të keni qasje në programet që ka nevojë fëmija juaj për të kryer detyrat e caktuara nga shkolla. Në rast se keni ndonjë pyetje, ju lutem kontaktoni mësuesin e fëmijës suaj ose koordinatoren 504 për shkollën tuaj.

Shkollat dhe distriktet kanë identifikuar rrugë të ndryshme për të pasur qasje tek studentët dhe familjet. Gjatë javëve në vazhdim, mësuesit e fëmijës suaj dhe drejtuesit e shkollës do të vazhdojnë të zhvillojnë dhe zgjerojnë mënyrat për të ofruar shërbime në distancë për arsimin e posaçëm.

Ne inkurajojmë drejtuesit e shkollave, mësuesit dhe familjet që të punojnë së bashku për të gjetur rrugët më të mira për të mbështetur secilin fëmijë gjatë kësaj periudhe sfiduese.

Sinqerisht

Russell D. Johnston, PhD
Komisioner i Asociuar i Lartë